

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës.

Kriteret e punësimit në vendin vakant për personel ndihmësakademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në pozicionin laborant janë si më poshtë vijon:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në një universitet brenda ose jashtë vendit, në programe të integruara të studimit të ciklit të dytë ose në programe të ciklit të parë dhe /ose të ciklit të dytë në Arkitekturë/Inxhinieri Ndërtimi/Gjeodezi/Elektronike,
2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, me një notë mesatare ≥ 7 (shtatë).
3. Preferohet të ketë njohuri në pajisje laboratorike, që kanë të bëjnë me fushën e Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës (total station, 3D scanner, etj dhe programet respektive).
4. Të ketë njohuri në programet e Microsoft Office (Word, Excel, Power Point, etj), Auto CAD dhe Photoshop.
5. Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore, të mbrojtur dhe vërtetuar me dëshmi (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
6. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
7. Preferohet të ketë eksperiencë pune mbi dy vite.
8. Të ketë njohuri mbi statutin e UPT-së dhe rregulloret e FAU-t, të cilat ndikojnë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e departamentit.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Dy letra referencash.
7. Vërtetim dhe/ose letër reference të punësimeve paraardhëse.
8. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
11. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **06.05.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.